



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

---

Numri i lëndës: 2021:096710

Datë: 14.10.2022

Numri i dokumentit: 03528148

P.nr.142/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA KAÇANIK, Gjyqtari Burim Çaka me procesmbajtësen Kosovare Axhami, në çështjen penale kundër të pandehurve: 1. I.R nga Kaçaniku, 2. I.R nga Kaçaniku, 3. E.B nga Kaçaniku, 4. F.S nga Kaçaniku, të akuzuar për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 me nenin 31 të KPRK-së, dhe veprës penale në bashkëkryerje Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës Prokurorisë Themelore Ferizaj me numër PP/II.nr.752/21 të datës 04.06.202, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më datë 29.09.2022, publik, në praninë e Prokurores së Shtetit Mimoza Sylja Hysenei, të pandehurve, palëve të dëmtuara A. I., K.B dhe K.B, më datë 30.09.2022 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë **14.10.2022 përpiloi** këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: I.R nga Kaçaniku Rr. “...” Komuna e Kaçanikut, i lindur më datë ..., nga i ati Z... dhe e ëma K..., e gjinisë Sh..., me numër personal ..., ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, punon në kompaninë “...”, i gjendjes së mesme ekonomike, shtetas i Republikës e Kosovës, i gjykuar, ka qenë në arrest shtëpiak nga data 19.05.2021 deri më datë 17.06.2021

I pandehuri: I.R nga Kaçaniku Rr. "...", Komuna e Kaçanikut, i lindur më datë ..., nga i ati Z... dhe e ëma K..., e gjinisë Sh..., me numër personal ..., ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, shtetas i Republikës e Kosovës, i pa gjykuar më parë, ka qenë në arrest shtëpiak nga data 19.05.2021 deri më datë 17.06.2021

I pandehuri: E.B nga Kaçaniku Rr. "... - Komuna e Kaçanikut, i lindur më datë ..., nga i ati F... dhe e ëma L..., e gjinisë D..., me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, punon si punëtor fizik, i gjendjes së mesme ekonomike, shtetas i Republikës e Kosovës, i pa gjykuar më parë, ka qenë në arrest shtëpiak nga data 19.05.2021 deri më datë 17.06.2021

I pandehuri: F.S nga Kaçaniku Rr. "...", Komuna e Kaçanikut, i lindur më datë ..., nga i ati Fadil dhe e ëma F..., e gjinisë T..., me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, shtetas i Republikës e Kosovës, i pa gjykuar më parë, ka qenë në arrest shtëpiak nga data 19.05.2021 deri më datë 17.06.2021

## JANË FAJTOR

I. Me datë 18.05.2021 rreth orës 20:50 në Rrugën "Agim Bajrami" në Kaçanik, brenda oborrit të kalasë, në bashkë kryerje dhe së bashku me 2 të mitur E.H dhe R.B, me mjete të forta – shkopinjë druri dhe boks të hekurit, i shkaktojnë lëndime të rënda trupore të dëmtuarit M... J..., në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje verbale fillimisht të pandehurit I..., I..., E... së bashku me të miturit E.H dhe R.B, e kanë goditur me shkopinjë druri në të gjitha pjesët e trupit të dëmtuarin M..., pastaj i pandehuri Ilir me një boks të hekurit e ka goditur të dëmtuarin në pjesën e fytyrës, duke ia thyer dhëmbët, me ç'rast i dëmtuari pëson lëndime të rënda trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, si ndrydhje të indeve të buta në regjionin e kokës, regjionin e kraharorit dhe regjionin e dy anëve të trupit dhe plagë shqyese ndrydhëse në regjionin e buzës së sipërme të gojës, thyerje e dhëmbëve 31 dhe 32

- Me këto veprime në bashkë kryerje kanë kryer veprën penale Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 me nenin 31 të KPRK-së

II. Me datë 18.05.2021 rreth orës 20:50 në Rrugën "Agim Bajrami" në Kaçanik, brenda oborrit të kalasë, në bashkë kryerje dhe së bashku me 2 të mitur E.H dhe R.B, me dashje dhe me mjete të forta –

shkopinjë druri, iu shkaktojnë lëndime të lehta trupore të dëmtuarve K.B dhe A. I., në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje verbale, fillimisht të pandehurit I., I. E. dhe F...ur së bashku me të miturit E.H dhe R.B, e kanë goditur me shkopinjë druri në të gjitha pjesët e trupit dhe shpinës të dëmtuarin K. B., me ç'rast i dëmtuari K. B. pëson lëndime të lehta trupore edhe atë ndrydhje të ndeve të buta në regjionin e kokës dhe regjionin e krahërorit dhe A. I. pëson lëndime të lehta trupore atë ndrydhje të ndeve të buta në regjionin e kokës dhe regjionin e krahërorit

- Me këto veprime në bashkëkryerje Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së

Gjykata në bazë të nenit lartcekur dhe neneve 2, 17, 38, 39, 42, 43, 46, 47, 48, 69, 70, 71 dhe 72, 76 të KPRK-së, 359, 360, 361 dhe 365 të KPPK-së, i:

#### CAKTON

a) Të pandehurve veprën penale nga pika I e dispozitivit secilit veç e veç u cakton dënim me burgim në kohëzgjatje nga 8 (tetë) muaj

Të pandehurve veprën penale nga pika II e dispozitivit secilit veç e veç u cakton dënim me burgim në kohëzgjatje nga 5 (pesë) muaj

Konform nenit 76 par 1 dhe 2 pika 2.2 dhe 2.4 të KPRK-së, Gjykata të pandehurit i:

#### GJYKON

1. Të pandehurve u shqipton dënim unik me burgim secilit veç e veç në kohëzgjatje prej 1 viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet po që se të pandehurit secilit veç e veç në afat prej 2 viteve nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në dënimin e shqiptuar secilit veç e veç u llogaritet koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 19.05.2021 deri më datë 17.06.2021

2. Detyrohen të pandehurit që në emër të shpenzimeve procedurale dhe në emër të paushallit gjyqësor secili veç e veç të paguaje shumën nga 50,00 €, si dhe për Fondin për Kompensimin e viktimave të krimit secili veç e veç të paguaj shumën nga 30€ të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Ferizaj ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.752/21 të datës 04.06.2021, kundër të pandehurve 1.I.R, 2. I.R, 3. E.B, 4.F.S dhe 5.Korab Trena të akuzuar për shkak të veprës penale në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 me nenin 31 të KPRK-së, dhe veprës penale në bashkëkryerje Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 29.09.2022.

Në këtë seancë ndaj të pandehurit Korab Trena është veçuar procedura për të gjitha pikat e aktakuzës.

Në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit, të pandehurit I.R, I.R, E.B dhe F.S e kanë pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, kanë deklaruar se janë penduar, ju kanë kërkuar falje palëve të dëmtuara dhe i kanë premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsërisin vepra penale.

Prokurori i Shtetit duke shprehur mendimin e tij lidhur me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë për të pandehurit, ngase e njëjta është bërë konform nenit 248 të KPP-së dhe i ka propozuar gjykatës që të pandehurit t'i shpall fajtorë dhe t'u shqiptoj dënim sipas ligjit.

Pala e dëmtuar A. I.i ka deklaruar se është dakord me pranimin e fajësisë, nuk parashtron kërkesë pasurore juridike dhe nuk i bashka ngjitem ndjekjes penale.

Pala e dëmtuar M. Ja. ka deklaruar se është dakord me pranimin e fajësisë, nuk parashtron kërkesë pasurore juridike dhe nuk i bashka ngjitem ndjekjes penale.

Pala e dëmtuar K.B. ka deklaruar se është dakord me pranimin e fajësisë, nuk parashtron kërkesë pasurore juridike dhe nuk i bashka ngjitem ndjekjes penale.

### *Vlerësimi i pranimin të fajësisë*

Pasi që të pandehurit e kanë pranuar fajësinë gjatë shqyrtimit fillestar, gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par 1 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se: të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit; Pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokuroria e Shtetit të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore; Akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurve ekzistojnë gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprave penale në bashkëkryerje Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 me nenin 31 të KPRK-së, dhe veprës penale në bashkëkryerje Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si në mënyrë kohë dhe vend si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin e parë gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69, 70 të KPRK-së, si rrethanë posaçërisht lehtësuese se i njëjti e ka pranuar fajësinë në shqyrtim fillestar, ndihet i penduar për veprimin e tij dhe se i ka premtuar Gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë më veprime të tilla, nuk ka të dhëna se është recidivist, si dhe heqjen dorë nga ndjekja penale nga pala e dëmtuar, është i moshës se re,

ndërsa si rrethanë rënduese nuk gjeti përpos veprimeve të cilat e përmbushin figurën e veprës penale.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin e dytë gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69, 70 të KPRK-së, si rrethanë posaçërisht lehtësuese se i njëjti e ka pranuar fajësinë në shqyrtim fillestar, ndihet i penduar për veprimin e tij dhe se i ka premtuar Gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë më veprime të tilla, nuk ka të dhëna se është recidivist, si dhe heqjen dorë nga ndjekja penale nga pala e dëmtuar, është i moshës së re, ndërsa si rrethanë rënduese nuk gjeti përpos veprimeve të cilat e përmbushin figurën e veprës penale.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin e tretë gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69, 70 të KPRK-së, si rrethanë posaçërisht lehtësuese se i njëjti e ka pranuar fajësinë në shqyrtim fillestar, ndihet i penduar për veprimin e tij dhe se i ka premtuar Gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë më veprime të tilla, nuk ka të dhëna se është recidivist, si dhe heqjen dorë nga ndjekja penale nga pala e dëmtuar, është i moshës së re, ndërsa si rrethanë rënduese nuk gjeti përpos veprimeve të cilat e përmbushin figurën e veprës penale.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin e katërt gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69, 70 të KPRK-së, si rrethanë posaçërisht lehtësuese se i njëjti e ka pranuar fajësinë në shqyrtim fillestar, ndihet i penduar për veprimin e tij dhe se i ka premtuar Gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë më veprime të tilla, nuk ka të dhëna se është recidivist, si dhe heqjen dorë nga ndjekja penale nga pala e dëmtuar, është i moshës së re, ndërsa si rrethanë rënduese nuk gjeti përpos veprimeve të cilat e përmbushin figurën e veprës penale.

Gjykata, të pandehurve u shqiptoi atë dënim duke e marrë për bazë minimumin dhe maksimumin dhe qëllimin e dënimit dhe duke u bazuar në rrethanat lehtësuese dhe është i bindur se edhe me një dënim të tillë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit.

*Vendimi për kërkesat pasurore juridike*

Palët e dëmtuara kanë hequr dorë nga kërkesat pasurore juridike.

*Vendimi për shpenzimet e procedurës*

Konform neneve 450 dhe 453 të KPPK-ës, u detyruan të pandehurit që secili veç e veç në emër të shpenzimeve të procedurës të paguaj shumën nga 20€ (për ekspertizën mjeko – ligjore) si dhe në emër të paushallit gjyqësor secili veç e veç të paguajnë shumën nga 30.00€ dhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 39 par 3 pika 3.1 të ligjit Ligji Nr. 05/L -036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit gjykata i obligoi të pandehurit që secili veç e veç të paguaj shumën nga 30.00€ Fondit për Kompensimin e viktimave të krimit dhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të neneve 248 dhe 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

Dega në Kaçanik

P.nr.142/21 datë 14.10.2022

Procesmbajtësja  
Kosovare Axhami

Gjyqtari  
Burim Çaka

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.